Prishtinë, 21 shtator 2023
Kodi i ZRRE-së: V_1768_2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 25, Nenin 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Vendimin V_1332_2020 të datës 10 dhjetor 2020;
- Vendimin V_1637_2022 të datës 27 dhjetor 2022;
- Vendimin Nr. V_1638_2022 të ZRRE-së lidhur me aprovimin e Rregullat dhe Procedurat (Kushtet e Përgjithshme, Përkufizimet, Procedura e Tregtimit si dhe Procedura e klerimit dhe shlyerjes) e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike SH.A. Dega në Kosovë (ALPEX);
- Dispozitat Nenit B.2.1 paragrafi B.2.1.5 pika c), Nenit B.3.2, Nenin J. 5, të Rregullave të ALPEX;
- Dispozitat e Nenit B.1.3 paragrafi B.1.3.1 pika a), Nenit B 2.1, Nenit B.2.3, Nenit B.1.5, Nenit B.1.6 të Procedurës së Tregtimit të ALPEX;
- Vendimin nr. V_1748_2023 të ZRRE-së lidhur me përcaktimin e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX SH.A. si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), për kryerjen e Aktiviteteve të Ndërlidhura me Bashkimin e Tregut të një ditë para dhe ndërditor dhe Operimin e Tregut të Bashkuar për territorin e Republikës së Kosovës;
- Kërkesën Nr. 316 e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX SH.A. Dega në Kosovë, të datës 06.07.2023 dhe propozimet për aprovimin e kërkesave sipas shkresave Nr. 317, 318, 319, 320, 321, 324 dhe 325;

në seancën e mbajtur me datë 21 shtator 2023 nxori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** – Propozimi për aprovimin e produkteve dhe llojet e urdhërporosive që do të tregtohen fillimisht në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX SH.A.

II. **APROVOHET –** Propozimi për aprovimin e rregullit të përcaktimit të Urdhërporosive fituese në

rastin kur një segment i grupuar i Urdhërporosive Shitjeje/Blerjeje do të pranohet pjesërisht sipas parashikimeve të seksionit B.2.1 të Procedurës së Tregtimit.

III. **APROVOHET** – Propozimi për aprovim lidhur me përcaktimin e Portofoleve të Anëtarëve të Bursës që do trajtohen me Urdhërporosi Marrëse të Çmimit me Përparësi (Shitjeje/Blerjeje) dhe renditjen e tyre sipas prioritetit në Tregjet e Ankandeve të Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX SH.A.

IV. **APROVOHET** – Propozimi për aprovim të Çmimeve Maksimale dhe Minimale te Urdhërporosive për Tregun e Ankandeve te Ditës në Avancë.

V. **APROVOHET** – Propozimi për aprovim të Marrëveshjes për Anëtarësim në Bursë për Tregun e Kosovës.

VI. **APROVOHET** – Propozimi për aprovimin e Kufirit Minimal dhe Maksimal të Lejuar të Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë (Maximum and Minimum Price Threshold), për të cilin ALPEX-i i referohet si mundësi për kryerjen e një ankandi të dytë, sipas përcaktimeve të Procedurës së Tregtimit.

VII. **APROVOHET** – Propozimi për Aprovimin e Procedurës së Komitetit të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike - ALPEX SH.A.

VIII. **OBLIGOHET** – Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX SH.A. Dega në Kosovë, sipas dispozitivit në pikën I. të këtij Vendimi, që Tregtimi në ALPEX vetëm me urdhërporosi te thjeshta të jetë me afat prej 24 muaj nga data e miratimit të këtij dokumenti nga Bordi i ZRRE, dhe obligohet ALPEX që të njoftoj ZRRE-në, çdo 6 muaj lidhur me veprimet e ndërmarra lidhur me implementimin e kësaj pike.

IX. **OBLIGOHET** - Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX SH.A. Dega në Kosovë, sipas dispozitivit në pikën II. të këtij Vendimi, që në paragrafin 3 të përmirësohet gabimi teknik i referencës ligjore nga B.1.2. në B.2.1 ashtu siç është në dokumentin bazik (Procedura e Tregtimit), dhe të dërgohet në ZRRE.

X. **OBLIGOHET** - Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX SH.A. Dega në Kosovë, sipas dispozitivit në pikën III. të këtij Vendimi, të bëj plotësimin dhe ndryshimin e renditjes së Portofoleve të Anëtareve të Bursës, dhe duhet përshtatur sipas obligimeve dhe kërkesave ligjore në fuqi dhe renditja duhet të jetë si në vijim:

Portofolet e Anëtarëve të Bursës që duhet të vendosin Urdhërporosi Marrëse të Çmimit me Përparësi Blerjeje, do të renditen në kurbën e grupuar të blerjeve sipas prioriteteve të mëposhtme:

1. Sasia e energjisë energjia elektrike e blerë nga Portofoli i KESCO/FSHU (Furnizuesi i Shërbimit Universal,) e prodhuar nga BRE-të e bazuar në një kontratë dypalëshe midis KESCO/FSHU dhe Entitetit përgjegjës për këto sasi të energjisë elektrike që do të tregtohet në ALPEX si kontratë financiare, do të renditet e para në kurbën e grupuar të blerjeve.

2. Sasia e energjisë e blerë nga portofoli i KESCO/FSHU për volumet bazuar në një kontratë dypalëshe KESCO SH.A.-KEK SH.A. e cila do të tregtohet në ALPEX si kontratë financiare në kuadër të detyrimit të shërbimit universal do të renditet e dyta në kurbën e grupuar të blerjeve.
3. Sasia e energjisë e blerë nga Portofoli i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes KEDS SH.A. për blerjen e humbjeve e bazuar në një kontrate dypalëshe KEDS SH.A.-KEK SH.A. e cila do të tregtohet në ALPEX si kontratë financiare do të renditet e treta në kurbën e grupuar të blerjeve (aty ku aplikohet, proporcionalisht me KOSTT SH.A. për mbulimin e humbjeve).
4. Sasia e energjisë elektrike e blerë nga Portofoli i Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT SH.A.) për blerjen e humbjeve bazuar në një kontratë dypalëshe KOSTT SH.A.-KEK SH.A. e cila do të tregtohet në ALPEX si kontrate financiare, do të renditet e katërta në kurbën e grupuar të blerjeve (aty ku aplikohet, proporcionalisht me KEDS SH.A. për mbulimin e humbjeve).
5. Sasia e energjisë elektrike e blerë nga Portofoli i palës blerëse në një kontratë dypalëshe e cila do të tregtohet në ALPEX si kontratë financiare, do të renditet e pesta në kurbën e grupuar të blerjeve. Radha e renditjes së këtyre portofoleve brenda këtij prioriteti do të përcaktohet sipas gjurmës kohore të vendosjes së urdhërporosive.
6. Sasia e energjisë elektrike e blerë nga Portofoli i Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut SH.A. për blerjen e humbjeve në treg të lirë do të renditet e gjashta në kurbën e grupuar të blerjeve.

Portofolet e Anëtarëve të Bursës që duhet të vendosin Urdhërporosi Marrëse të Çmimit me Përparësi Shitjeje, do të renditen në kurbën e grupuar të shitjeve sipas prioriteteve të mëposhtme:

1. Sasia e energjisë elektrike e shitur nga portofoli i Entitetit përgjegjës që do të tregtoj në ALPEX energjinë elektrike të prodhuar nga BRE-të (të përfshira në skemën mbështetëse) do të renditet e para në kurbën e grupuar të shitjeve.
2. Sasia e energjisë elektrike e shitur nga portofoli i KEK Sh.A në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore, rregullative ose kontraktuale kundrejt KESCO-s do të renditet e dyta në kurbën e grupuar të shitjeve. KEK Sh.A do të vendos se cila pjesë e sasisë apo e gjithë sasia e energjisë së prodhuar për këto detyrime do të vendoset si Urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi Shitje nëpërmjet portofolit të krijuar për këtë qëllim.
3. Sasia e energjisë elektrike e shitur nga portofoli i KEK Sh.A në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore, rregullative ose kontraktuale kundrejt KEDS Sh.A do të renditet e treta në kurbën e grupuar të shitjeve. KEK Sh.A do të vendos se cila pjesë e sasisë apo e gjithë sasia e energjisë së prodhuar për këto detyrime do të vendoset si Urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi Shitje nëpërmjet portofolit te krijuar për këtë qëllim.
4. Sasia e energjisë elektrike e shitur nga portofoli i KEK Sh.A në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore, rregullative kundrejt KOSTT Sh.A do të renditet e katërta në kurbën e grupuar të shitjeve. KEK Sh.A do të vendos se cila pjesë e sasisë apo e gjithë sasia e energjisë

së prodhuar për këto detyrime do të vendoset si urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi Shitje nëpërmjet portofolit të krijuar për këtë qëllim.

5. Sasia e energjisë elektrike e shitur nga Portofoli i palës shitëse në një kontratë dypalëshe, e cila do të tregtohet në ALPEX si kontratë financiare, do të renditet e pesta në kurbën e grupuar të shitjeve. Radha e renditjes së këtyre portofoleve brenda këtij prioriteti do të përcaktohet sipas gjurmës kohore të vendosjes së urdhërporosive
6. Sasia e energjisë elektrike e shitur nga portofolet e KEK Sh.A në rastet e regjimit të ruajtjes së minimumit teknik do të vendoset si urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi Shitje dhe do të renditet e gjashta në kurbën e grupuar të shitjeve.

XI. OBLIGOHET - Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX SH.A. Dega në Kosovë, sipas dispozitivit në pikën V. të këtij Vendimi të bëj plotësimin dhe ndyshimin nëparagrafin 15.3 të Marrëveshjes ku trajtohen Zgjidhjet e Mosmarrëveshjeve, i referohet Gjykatës në Tiranë, duhet të ndryshohet në mënyrë që referencë të jetë Gjykata në Kosovë, dhe të dërgohet dokumenti i përmirësuar në ZRRE.

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 06.07.2023 nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX SH.A. Dega në Kosovë, ka pranuar kërkesën Nr. 316 me propozimet për aprovimin e kërkesave sipas shkresave Nr. 317, 318, 319, 320, 321, 324 dhe 325.
- ZRRE në përputhje me kërkesat ligjore, ka vendosur në konsultim publik këto dokumente, ku palët e interesuara kanë pasur të drejt të paraqesin komentet dhe qëndrimet e tyre lidhur me çështjet e trajtuara në këto dokumente.
- ZRRE ka pranuar komentet nga palët, të cilat i ka vlerësuar dhe analizuar me shumë kujdes, dhe për çështjet që nuk ka pasur vërejtje janë marr në shqyrtim dhe vlerësim .
- Pas përfundimit të konsultimit publik, dhe pas përfshirjes së komenteve të ZRRE-së, dokumenti është përgatitur për shqyrtim dhe miratim, me ndryshimet e kërkuara nga ZRRE.
- ZRRE ka vlerësuar se duke pasur parasysh rëndësinë e procesit të hapjes dhe funksionalizimit të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, e cila është njëra ndër zhvillimet më të mëdha për tregun e energjisë elektrike në Republikën e Kosovës, për ta përmbyllur me sukses, ka marrë mbështetje edhe nga konsulenca ESA në kuadër të USAID, e cila ka ofruar ekspert vendorë dhe ndërkombëtarë, me njohje në fushën e bursave të energjisë elektrike.
- Bordi i ZRRE, pas vlerësimit dhe analizimit të propozimeve të lartëcekura ka konstatuar që kërkesat janë të drejta, dhe ka vlerësuar se të njëjtat janë të domosdoshme për funksionimin e sigurt të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike - ALPEX, prandaj ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

XII. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

XIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Arta Isufi, anëtare

Adnan Preniqi, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- ALPEX SH.A. – Dega në Kosovë, dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji.